



14 600
21/12/2015

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 1277 (31104-00056-83-2015)
Dt. Rregj. 28.05.2015

Nr. Vendimi 932(144)
Dt.Vendimi 02.12.2015

V E N D I M
"NE EMER TE REPUBLIKES"

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Shkoder e perbere nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana Liti sot me date 02.12.2015, ora 10.30 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore ceshtjen administrative me nr. rregj. them. 1277 (31104-00056-83-2015) date 28.05.2015 qe i perket palëve ndërgjyqëse:

PADITËSE: Florinda Hila, e bija Hiles, e dtl.23.09.1964, lindur ne Fshatin Shelqet, Shkoder dhe banuese ne lagjen "Ndoc Miti", Rr."Rrethi i Shkoder"

TE PADITUR: Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Shkoder(në mungesë).
Drejtoria Tatimore e Apelit Tirane(në mungesë).

OBJEKTI: 1-Konstatimin si akt absolutisht i pavlefshem te Akt-Konstatimit nr.3578 date 10.10.2014 ne emer te subjektit Artikuj te Ndryshem me numer Nipti L46611004R te tatimpagueses Florinda Hila.
2-Heqjen e gjobes ne formen e detyrimit tatimor te shumes 100.000 (Njeqindemije) leke te reja, te vendosur nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Shkoder dhe lene ne fuqi nga Drejtoria Tatimore e Apelit Tirane ne emer te subjektit Artikuj te ndryshem me numer Nipti L46611004R te tatimpagueses Florinda Hila.

BAZA LIGJORE: Neni 4, 7, 11, 13, 16, 17/c,18 te Ligjit Nr.49/2012 per Gjykatën Administrative". Neni 116/c I Kodit Procedurave Administrative te ndryshuar. Ligji Nr.9920, date 19.5.2008 "Per Procedurat Tatimore Ne Republiken E Shqiperise", I ndryshuar.

Gjykata ne perfundim te hetimit gjyqesor, pasi administroi provat shkresore te paraqitura, degjoi palën paditese në pretendimet përfundimtare i cili ka qenë i pranueshëm.

kërkesë padisë sipas objektit të saj ,në mungesë të palës së paditur,shqyrtoi dhe
çeshtjen ne teresi:

VEREN se:

Paditesia Florinda Hila, person fizik I eshte drejtuar Gjykates Administrative Shkalle
e Pare Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur Drejtoria e Pergjithshme e
Tatimeve Tirane, Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder
, me objekt;

1.Konstatimin si akt absolutisht te pavlefshem te akt konstatimit nr.3578 date
10.10.2014 ne emer te subjektit artikuj te ndryshem me numer Nipti 1.46611004R te
tatimpagueses Florinda Hila.

2.Heqjen e gjobes ne formen e detyrimit tatimor,te shumes 100.000 leke te
vendosur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder, lene ne fuqi nga Drejtoria e
Apelimit Tatimor Tirane ne emer te subjektit, tatimpagueses Florinda Hila.

Rrethanat e ceshtjes

Subjekti Florinda Hila eshte rregjistruar prane organit tatimor me numer Nipti F466I
1004R, me objekt aktiviteti "tregtim artikuj te ndryshem".

Nga ana e organit tatimore me procesverbal konstatimin nr 0434521 dt 10.10.2014
tek subjektit tatimpagues Florinda Hila nga grupi I inspektoreve Genti Bilali dhe Eris
Llukacej, eshte konstatuar qe "subjekti nuk ka te instaluar kasen fiskale" per rrjedhoje
subjekti penalizohet me gjobe 100.000 leke, sipas procesverbalit gjobe nr 0057461 dt
10.10.2014.

Kontrolli u krye ne oren 12.30 min.

Per tatimpaguesin (refuzon firmen) per administraten (grupi I kontrollit firmen).

Mbi bazen e ketije akt konstatimi ka dale dhe njoftim vleresimi tatimore nr 8581/1 dt
22.10.2014 qe ngarkon paditesen me gjobe, 100.000 leke , mos paisje me kase fiskale,
qe sht eshte ushtruar ankim ne apelimin tatimore Tirane, e cila me vendimin nr
8135/1 dt 14.05.2015 ka refuzuar ankimin, pasi eshte dorezuar jashte afateve,per pasoje
paditesia i eshte drejtuar gjykates me kerkese padi per pa vlefshmeri absolute te akt
konstatimit dhe te detyrimit qe rrjedhe nga njoftim vleresimi i siper treguar.

Ne gjykim paditesja parashtroi se;

.....Kontrolli nuk eshte kryer me dt 10.10.2014(sic eshte shenuar ne akt-
konstatimin e po kesaj date) ne me date 09.10.2014 iane paraqitur prane biznesit
grupi i Kontrollit Tatimor dhe me paralajmeruan per te blere Kasen Fiskale, dhe po ate
dite kam here procedurat e aplikimit te pajisjes fiskale dhe me daten 10. 10. 2014 kam
mbyllur dyqanin dhe kam bere pagosen e faturave te kasas fiskale ne banke.Ne vazhdim
nuk jam lajmeruar per venie gjobe.

Pas 4 muajsh nga nje kontroll i imi kam gjetur ne sistemin tatimor ne niptin tim nje
gjobe prej 100.000 lekesh per kasen fiskale ne nje kohe qe nuk me ka lajmeruar njeri
dhe nuk eshte paraqitur askush per berjen e procesverbalit.

Gjithashtu nuk me eshte lene nje kopje e procesverbalit ne te cilin shkruhej qe une
kam refuzuar firmen, ne nje kohe ku grupi i kontrollit tatimor nuk eshte paraqitur me. Pasi
jam vene ne dijeni per problemin jam paraqitur ne zyren e kasave fiskale ne Drejtorine
Rajonale Tatimore Shkoder dhe kam pare procesverbalin e akt-konstatimit te dates
10.10.2014 ku shkruhej se ne oren 12:35 eshte bere procesverbali dhe une
Florinda Hila kam refuzuar firmen.

Biznesi im prej ores 11.00 te asaj dite deri ne oren 14.00 ka qene i mbyllur.

... dhe prania e parashtimit para gjyqes ka pretenduar se,

Neni 116 i tij shprehet ne lidhje me "Aktet administrative absolutisht te pavlefshme" :*Aktet administrative do te quhen absolutisht (e pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, ne rastet e meposhtme :*

- b) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore

c) kur akti është nxjerre ne kundershtim me formen dhe procedure e kerkuar nga ligji
Nuk jemi as para ketij shkakut duke sqaruar sa me poshte :

Ne Akt konstatim **0434521** date **10.10.2014** eshte pasqyruar gjendja e konstatuar ne fakt ne momentin e kontrollit nder te tjera shprehet :

Pala paditese nuk provoi te kunderten, po pranon se nuk ka patur kase fiskale dhe e ka blere ate pas kontrollit.

Ai nuk argumenton, provon asnje shkak te pavlefshmerise se aktit administrativ. Subjekti ka marre dijeni per aktet e mbajtura prane tij dhe ne vijim njoftim vleresimin tatimor, ku ne vijim ka apeluar prane" Drejtorise se Apelimit Tatimor ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve Tirane. e cila eshte shprehur me vendimin e saj, per pasopje kerkojme rrezimin e kerkese padise.

Referuar argumente ligjore mbi bazen e te cilit eshte ngarkuar paditesi tatimpagues Florinda Hila me gjobe 100.000 leke, konfrom nenit 122 te ligjit 9920/2008 , nuk eshte zbatuar korrekt pasi sipas nenit 122,"Kundervajtjel administrative ne perdorimin, e

7

a) nuk instalon pajisjen fiskale per regjistrimin e pagesave me para ne dore :

Duke iu kthyer rastin ne gjykim, rezultoi se ne akt konstatimin e mbajtur me dt 10.10.2014, eshte konstatim per te paren here ne te cilin nuk eshte bere paralajmerimi sipas dispozites se mesiprme per 10 dite pune, ku subjekti duhet te blinte kasen fiskale, por eshte operuar direkt me gjobe.

Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin dhe personat e tatueshem, tatimpagues i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel" jane te detyruar te pajisen. te perdorin dhe mirembajne pajisjet fiskale ne perputhje me dispozitat e Vendimit te Keshillit te Ministrave **nr. 781, date 14.11.2007 "**

Inspektoret tatimore kryejne rregullisht kontrole per leshimin e kuponeve tatimore dhe mbajne procesverbale kur konstalojne shkelje duke vendosur ne vend gjoben sipas percaktimeve ligjore, per tatimpaguesit dhe per klientet shkeles te ligjit".

Referuar ketyre udhezimeve me te vertete administrata tatimore ka nje funksion te tille, por veprimet aio duhet ti beje ne prezence te subjektit qe kontrollohet, nga akt konstatimi provonet se ora e mbajtes se tij, cante 12.30 min, ndersa ne baze prove paditesia ka paraqitur ne gjykate, mandat pagesa e bankes CREDINS e cila tregon shumen e derdhur per kasen fiskale ne shumen 46.200 leke te reja, daten 10.10.2014 , pagese e bere nga vete subjekti Florinda Hila dhe oren e pageses 12.30 min. (nderkohe ora e shenuar ne akt - konstatimin eshte 12.35 min). Pra paditesi nuk ka si te ndodhet ne te njejten ore ne dy vende te ndryshme, pasi objektet jane ne nje distance te kon siderueshme nga njera tjetra dhe per pese minuta nuk munde te arrihet.

Persa I perket pretendimit te anes se paditur qe nuk ka pse goditet per pa-
resimi tatimore, eshte I gabuar, pasi qe vendimi dt 10.10.2014 eshte veprim
administrative, mbi bazen e te cilit kane rrjedhur dhe detyrimi ne baze te ligjit, dhe se
njoftimi -vleresimi eshte akt administrative qe I komunikohet tatimpaguasit per detyrimin

ne ngarkim te tije, per pasoje neqoftese veprimi administrativ akt - konstatimi eshte nje veprim absolutisht i pa vlefshem (si dhe ne rastin ne gjykim) ateherë dhe aktet qe ka prodhuar ky veprim jane akte absolutisht te pa vlefsheme .Nul.

Perfundimisht nga sa me siper analizoi gjykata arrine ne perfundimin se kerkese padia eshte e mbeshtetur ne prova dhe ligj dhe se perfundimisht vendose pranimin e saj, prandaj

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 45 te ligjit nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative" 126 dhe 306 të K. Pr. Civile

VENDOSI

-Pranimin e kërkesë padisë.

-Deklarimimin si akte absolutisht te pavlefshem te aktit te konstatimit nr.3578 date 10.10.2014, te proces verbalit te gjoses nr. 57461 dt.10.10.2014 ne emer (te subjektit Artikuj te Ndryshem me numer Nipti L46611004R), te tatimpagueses Florinda Hila.

-Heqjen e gjoses ,si detyrim tatimor në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë te venë nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Shkoder, lene ne fuqi nga Drejtoria Tatimore e Apelit Tirane ne emer (te subjektit Artikuj te ndryshem me numer Nipti L46611004R), te tatimpagueses Florinda Hila

-Shpenzimet gjyqsore sic janë bërë.

-Ky vendim përbën titull ekzekutiv është i formës së prerë dhe do te ekzekutohet menjëherë.

Kundër vendimit nuk lejohet ankim.

Shkodër me datë 02.12.2015

SEKRETARE SEANCE

Florinda Lili

